



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

## Raport Konsultativ

### Shqyrtimi i Pestë i Tarifave të Energjisë Elektrike SHTE5 (2011-2012)

#### DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE për të marrë komente eventuale nga palët e interesit. Dokumenti nuk paraqet vendim të ZRRE-së.

**Prishtinë, 22 shkurt 2011**

## Përmbajtja

|  |           |
|--|-----------|
| <b>PËRMBLEDHJE</b> .....   | <b>3</b>  |
| <b>1 Hyrje</b> .....   | <b>4</b>  |
| <b>2 Struktura e dokumentit</b> .....  | <b>4</b>  |
| <b>3 Kërkesa dhe furnizimi me energji elektrike</b> .....                                  | <b>5</b>  |
| <b>4 Të Hyrat e Lejuara</b> .....  | <b>7</b>  |
| 4.1 Qasja .....  | 7         |
| 4.2 Kostoja e importit .....   | 8         |
| 4.3 Shpenzimet tjera operative .....   | 9         |
| 4.3.1 Borxhet e këqija .....   | 9         |
| 4.3.2 Margjina e furnizimit.....   | 9         |
| 4.3.3 Ngarkesat e KOSTT-it .....   | 10        |
| 4.4 Shpenzimet kapitale, Baza e Rregulluar e Aseteve, Zhvlerësimi dhe Kthimi i Lejuar..... | 10        |
| 4.5 Të Hyrat e parregulluara.....  | 10        |
| 4.5.1 Subvencionet për import .....  | 10        |
| 4.5.2 Të Hyrat e parregulluara nga shitjet te konsumatorët e kualifikuar.....              | 10        |
| 4.6 Përshtatjet .....  | 11        |
| 4.6.1 Përshtatjet për shpenzimet kapitale.....   | 11        |
| 4.6.2 Lejimet për import emergjent.....  | 12        |
| 4.6.3 Përshtatja e Subvencioneve.....  | 12        |
| 4.6.4 Rregullimi i furnizimit në veri të lumit Ibër .....                                  | 13        |
| 4.7 Përmbledhje e të Hyrave të Lejuara .....   | 13        |
| <b>5 Ngarkesat e propozuara të SHSD</b> .....  | <b>15</b> |
| <b>6 Çështjet e tjera</b> .....  | <b>15</b> |
| 6.1 <i>Tarifa e nivelit 220 kV</i> .....   | 15        |
| 6.2 <i>Vlerësimi i asetëve para vitit 2006</i> .....                                       | 16        |
| 6.3 Tantiema për linjit .....  | 17        |
| <b>7 Propozimet e ZRRE-së për tarifat e rregulluara</b> .....                              | <b>17</b> |

## Përmbajtja

|       |  |    |
|-------|--|----|
| 7.1.1 | Të Hyrat e Lejuara .....                   | 17 |
| 7.1.2 | Përshtatja e propozuar e tarifave .....    | 17 |
| 7.1.3 | Llogaria Balancuese e Tarifave (LBT) ..... | 18 |
| 7.1.4 | Struktura tarifore .....                   | 19 |

### PËRMBLEDHJE

- KEK-u me aplikacionin e vet ka kërkuar të Hyra të Lejuara për vitin 2011 në vlerë prej €201 milionë. Pas shqyrtimit të aplikacionit dhe zbatimit të rregullimeve të nevojshme, ZRRE ka vlerësuar se të Hyrat e Lejuara të nevojshme për KEK-un si furnizues publik për vitin 2011 janë €184.6 milionë.
- Të Hyrat e kërkuara në Aplikacionin e KEK-ut do të paraqisnin një rritje mesatare të tarifës së rregulluar në krahasim me tarifën e tanishme për 3.5% respektivisht 5.78 €/kWh.
- Të Hyrat e Lejuara të vlerësuara nga ZRRE rezultojnë me një ulje mesatare të tarifës së rregulluar për 8.2% respektivisht 5.13 €/kWh.
- Ndryshimet në legjislacionin primar kërkojnë përshtatje edhe të legjislacionit sekondar, përkatësisht Metodologjisë Tarifore, që pritet të shkaktojë rritje shtesë të tarifave të energjisë.
- **Duke pasur parasysh këtë, ZRRE propozon që tarifën për vitin 2011 të mos ndryshohet dhe të mbetet në të njëjtin nivel me atë të vitit 2010.**
- Ndryshimi në mes të të Hyrave të arkëtuara sipas tarifave të aprovuara dhe të të Hyrave të vlerësuara në këtë raport, do të kreditohet në **Llogarinë Balancuese të Tarifave**. Mjetet nga kjo llogari do të përdoren për të zbutur rritjet e pritura të tarifave në vitet e ardhshme.
- Palët e interesit mund të japin komente lidhur me këtë Raport deri më 4 mars 2011.
- **Vërejtje: Propozimi i ZRRE-së bazohet në supozimin se niveli i subvencionit për import nga BKK për vitin 2011 do të jetë 33.05 milionë euro, siç është dhënë në Draft Buxhetin e Kosovës. Ky propozim do të ndryshojë nëse ndryshohet vlera e subvencionit për import në Buxhetin e aprovuar.**

### 1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e shqyrtimit të pestë të tarifave të energjisë elektrike me pakicë, që do të aplikohen nga KEK sh.a<sup>1</sup>, dhe të ngarkesave të transmisionit, që do të aplikohen nga KOSTT sh.a., duke filluar nga data 1 prill 2011. Shqyrtimi përfshin si nivelin e të Hyrave të Lejuara që duhet të mbliidhen nga KEK dhe KOSTT (tash e tutje “të licencuarit”) nga tarifat e ngarkesat e rregulluara në 2011-2012, ashtu edhe strukturën e këtyre tarifave dhe ngarkesave.

ZRRE ka pranuar aplikacionin e KEK-ut më 28 janar të vitit 2011. Aplikacioni i KEK-ut është publikuar në ueb-faqen e ZRRE-së, krahas këtij Raporti Konsultativ. Raporti Konsultativ paraqet qëndrimet e ZRRE-së mbi aplikacionin e KEK-ut dhe propozimet e ZRRE-së për nivelin e tarifave të reja me pakicë për konsumatorët e rregulluar, si dhe ngarkesat për Shfrytëzimin e Sistemit të Distribucionit (SHSD) që pritet të hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2011.

ZRRE fton të gjitha palët e interesit të japin komentet e tyre eventuale për qëndrimet e ZRRE-së të dhëna në këtë Raport. Komentet eventuale do të pranohen deri më datën 4 mars 2011, dhe duhet të dërgohen me e-mail në: [ero.pricing-tariffs@ero-ks.org](mailto:ero.pricing-tariffs@ero-ks.org), me titullin “Komente për SHTE5”. Komentet në formë të shkruar duhet të dërgohen në adresën e ZRRE-së: **Rr. Hamdi Mramori nr. 1, 10000 Prishtinë, Kosovë**, të dedikuara për “Departamentin për Tarifa dhe Çmime”.

Në një Raport Konsultativ tjetër është shqyrtuar aplikacioni i pranuar nga KOSTT-i, që mbulon ngarkesat e rregulluara për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit (SHST), ngarkesat e Operatorit të Tregut (OT) dhe ato të Operatorit të Sistemit (OS). Raporti Konsultativ për KOSTT-in si dhe aplikacioni i KOSTT-it poashtu janë publikuar në ueb-faqen e ZRRE-së.

Për shqyrtimin e aplikacioneve të të licencuarve ZRRE ka zbatuar metodologjinë tarifore në fuqi, siç ka vepruar në shqyrtimet paraprake tarifore. Sipas Ligjit të sapo miratuar për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185, do të ndryshohet metodologjia tarifore. Këto ndryshime duhet të bëhen brenda nëntë muajve pas miratimit të ligjit. Në ndërkohë, ZRRE do të vazhdojë së aplikuari metodologjinë e deritanishme.

**Duhet të theksohet se ZRRE ende nuk ka marrë ndonjë vendim për nivelin e tarifave që do të miratohen. Propozimet e ZRRE-së në këtë dokument janë preliminare me qëllim të pranimit të komenteve eventuale nga palët e interesit.**

### 2 Struktura e dokumentit

Raporti Konsultativ është organizuar si vijon:

---

<sup>1</sup> Më tutje në këtë dokument KEK sh.a. do t’i referohemi si “KEK”, dhe KOSTT sh.a. si “KOSTT”

## Kërkesa dhe furnizimi me energji elektrike

- Në pjesën 3 të dokumentit shqyrtohen parashikimet e KEK-ut për kërkesën e energjisë, humbjet, furnizimin dhe importin.
- Në pjesën 4 të dokumentit shqyrtohen propozimet e KEK-ut për të Hyrat e Lejuara që duhet të mblidhen nga tarifat e rregulluara me pakicë.
- Në pjesën 5 të dokumentit shqyrtohet propozimi i KEK-ut për strukturën e tarifave të SHSD-së.
- Në pjesën 6 të dokumentit shqyrtohen çështjet e tjera që janë ngritur në këtë aplikacion.
- Në pjesën 7 të dokumentit paraqiten propozimet e ZRRE-së për tarifat e rregulluara që do të aplikohen nga 1 prilli i vitit 2011.

### 3 Kërkesa dhe furnizimi me energji elektrike

Parashikimet e KEK-ut për kërkesën dhe furnizimin me energji elektrike bazohen në Bilancin Energjetik të vitit 2011, të lëshuar nga KOSTT-i në nëntor të vitit 2010<sup>2</sup>.

KEK ka respektuar porosinë e ZRRE-së që parashikimet për furnizimin dhe kërkesën me energji elektrike të bazohen në Bilancin e publikuar energjetik. Megjithatë, ZRRE konsideron se është e nevojshme të bëhen dy ndryshime të parashikimeve të bëra nga KEK. Në të dyja rastet, këto ndryshime kanë të bëjnë me humbjet e supozuara në rrjetin e distribucionit.

- ZRRE ka përshtatur nivelin e humbjeve teknike nga 17.6%, sa ishin në aplikacionin e KEK-ut, në 17.1%, për të reflektuar nivelin e humbjeve të lejuara në shqyrtimet e kaluara tarifore, të cilat janë arritur nga KEK-u në vitin 2010<sup>3</sup>. ZRRE thekson se KEK-u ka realizuar investime të konsiderueshme kapitale në rrjetin e distribucionit, shumica prej të cilave janë investuar nga tarifat e konsumatorëve, dhe kjo do të duhej të kishte ndikuar në zvogëlimin e humbjeve teknike. Ndryshimi në mes të humbjeve të lejuara nga ZRRE dhe të atyre të kërkuara nga KEK është trajtuar si reduktim i importit ose, në muajt kur nuk ka pasur import të energjisë, si reduktim i prodhimit të energjisë elektrike nga gjeneratorët e KEK-ut.
- ZRRE po ashtu ka përshtatur nivelin e humbjeve komerciale nga 22.4% (që përbëhen nga humbjet komerciale dhe nga energjia e pa faturuar), në 20.0%, sa kishte lejuar në vitet e më

---

<sup>2</sup> ZRRE ka vërejtur një ndryshim të vogël në shitjet e rregulluara në mes të bilancit të KOSTT-it për vitin 2011 dhe aplikacionit të KEK-ut. Ndryshimi prej 4.2 GWh-ve që paraqet më pak se 0.1% të shitjeve konsiderohet i neglizhueshëm.

<sup>3</sup> Nëse i llogarisim në të njëjtën mënyrë siç është aplikuar nga ZRRE në bilancin energjetik të përdorur për të llogaritur të Hyrat e Lejuara, niveli i humbjeve teknike të KEK-ut në rrjetin e distribucionit në vitin 2010 del të jetë 17.2%.

## Kërkesa dhe furnizimi me energji elektrike

parme. Ky ndryshim është supozuar të jetë konvertuar në rritje të shitjeve të energjisë elektrike, që do të thotë konvertimi i energjisë të supozuar si e vjedhur, në energji të shitur. ZRRE konstaton se, nëse nuk përfshihet energjia e pa faturuar, KEK-u për këtë vit parasheh humbje komerciale prej 18.0%.

ZRRE po ashtu ka përshtatur nivelin e humbjeve të lejuara të transmisionit nga 2.7% sa është kërkuar nga KOSTT, në 2.3%. Arsyet për këtë përshtatje janë dhënë në Raportin Konsultativ për aplikacionin e KOSTT-it. Kjo përshtatje pritet të zvogëlojë nevojën për import ose, në muajt kur nuk ka import, nevojën për prodhim nga gjeneratorët e KEK-ut. Për këtë arsye, kjo përshtatje do të ketë ndikim në energjinë e furnizuar nga KEK-u.

Më poshtë është paraqitur bilanci energjetik i përshtatur nga ZRRE-ja, krahas atij të dorëzuar nga KEK-u. Qëndrimet e ZRRE-së kanë ndikuar që shitjet e parapara për konsumatorët e kyçur në distribucion të rriten nga 2,713 GWh në 2,828 GWh, që vëllimi i energjisë së importuar të zvogëlohet nga 891 GWh në 840 GWh ndërsa prodhimi nga gjeneratorët e KEK-ut të zvogëlohet nga 4,768 GWh në 4,753 GWh.

**Tabela 1: Bilanci Energjetik**

| <b>BILANCI ENERGJETIK</b>                  |            |                          |                |
|--|------------|--------------------------|----------------|
|  |            | <b>Aplikacioni i KEK</b> | <b>ZRRE</b>    |
| <b>Gjenerimi</b>                           |            |                          |                |
| Kosova A                                   | GWh        | 1,384.8                  | 1,370.3        |
| Kosova B                                   | GWh        | 3,382.9                  | 3,382.9        |
| HPP Ujmani                                 | GWh        | 82.0                     | 82.0           |
| <b>Gjithsej Gjenerimi</b>                  | <b>GWh</b> | <b>4,849.7</b>           | <b>4,835.2</b> |
| <b>Tregëtimi</b>                           |            |                          |                |
| Importi                                    | GWh        | 891.2                    | 840.0          |
| Eksporti                                   | GWh        | -194.2                   | -193.0         |
| <b>Gjithësej furnizimi në Transmision</b>  | <b>GWh</b> | <b>5,546.7</b>           | <b>5,482.2</b> |
| <b>Transmisioni</b>                        |            |                          |                |
| Humbjet në Transmision                     | GWh        | 172.3                    | 130.5          |
|  |            | 3.0%                     | 2.3%           |
| Shitjet në transmision                     | GWh        | 767.8                    | 772.6          |
| Konsumi i brendshëm i KEK                  | GWh        | 126.4                    | 126.4          |
| <b>Distribucioni</b>                       |            |                          |                |
| Energjia në hyrje nga transmisioni         | GWh        | 4,480.2                  | 4,452.7        |
| Gjenerimi I kyçur në distribucion          | GWh        | 42.9                     | 42.9           |
| <b>Gjithsej energjia në distribucion</b>   | <b>GWh</b> | <b>4,523.1</b>           | <b>4,495.6</b> |
| Humbjet teknike                            | GWh        | 796.7                    | 768.7          |
|  |            | 17.6%                    | 17.1%          |
| Humbjet komerciale                         | GWh        | 1,013.2                  | 899.1          |
|  |            | 22.4%                    | 20.0%          |
| <b>Shitjet e energjisë në distribucion</b> | <b>GWh</b> | <b>2,713.2</b>           | <b>2,827.7</b> |
| <b>Shitjet</b>                             |            |                          |                |
| Shitjet në transmision                     | GWh        | 767.8                    | 772.6          |
| Shitjet në distribucion                    | GWh        | 2,713.2                  | 2,827.7        |
| <b>Gjithsej shitjet</b>                    | <b>GWh</b> | <b>3,481.0</b>           | <b>3,600.3</b> |

Vërejtje: Ndryshimet e vogla në mes të aplikacionit të KEK-ut dhe qëndrimeve të ZRRE-së për eksport dhe për shitjet të konsumatorët e kyçur në distribucion rrjedhin nga fakti se ZRRE ka përdorur vlerat e Bilancit Energjetik të vitit 2011 dhe jo ato të aplikacionit të KEK-ut.

## 4 Të Hyrat e Lejuara

### 4.1 Qasja

ZRRE vlerëson ndaras të Hyrat e Lejuara për secilin aktivitet të licencuar të KEK-ut (gjenerimin, distribucionin dhe furnizimin). ZRRE po ashtu vlerëson të Hyrat e Lejuara të Minierave (të cilat

## Të Hyrat e Lejuara

përdoren për të vlerësuar kostot e furnizimit me thëngjill të divizionit të Gjenerimit) dhe të Hyrat e përbashkëta të divizionit të Administratës Qendrore (kostot e së cilës u alokohen divizioneve të tjera të KEK-ut, bazuar në numrin e punëtorëve të secilit divizion).

Të Hyrat e Lejuara për secilin divizion vlerësohen në bazë të “Ndërtimit me blloqe”. Kostot e Lejuara vlerësohen si shuma e shpenzimeve operative (që përfshijnë kostot e blerjes së energjisë jashtë KEK-ut, importin dhe shpenzimet e KOSTT-it), zhvlerësimin e aseteve pas vitit 2006, si dhe kthimin e lejuar për asetet e financuara komercialisht pas vitit 2006. Asetet e KEK-ut që i përkasin viteve para vitit 2006 janë vlerësuar të jenë zero dhe kthimi nuk është lejuar për asetet e financuara nga grantet (për arsye se KEK-u nuk ka kosto të financimit për to).

Të Hyrat e Lejuara që duhet të mblidhen nga tarifat e rregulluara vlerësohen duke zbritur të Hyrat e parregulluara (që përfshijnë shitjet ndaj palëve të treta, konsumatorëve të parregulluar si dhe importet). Në fund bashkërenditen ndryshimet në mes të shpenzimeve të lejuara dhe atyre të realizuara kapitale, si dhe për ato njësi kostosh e të hyrash të cilat janë jashtë kontrollit të të licencuarve (që përfshijnë koston e importit, subvencionet, kostot e licencave dhe tantimat).

Në këtë pjesë të Raportit Konsultativ do të shqyrtohen të gjitha nga këta komponentë të llogaritjes së të Hyrave të Lejuara.

### 4.2 Kostoja e importit

Në aplikacionin e SHTE5 KEK-u ka kërkuar çmim mesatar për blerjen e energjisë nga importi prej 59.66 €/MWh. Supozimi i KEK-ut është bazuar në çmimet aktuale si dhe ato të ofruara në kontratat e vitit 2011. ZRRE konsideron se çmimi i kërkuar nga KEK-u reflekton kushtet e tanishme të importit, andaj dhe ka pranuar kërkesën e KEK-ut në llogaritjen e të Hyrave të Lejuara.

Në SHTE4 KEK-u po ashtu kishte kërkuar që t’i lejohet një shumë për blerjen e energjisë nga importi në vitin 2010. Kjo kërkesë nuk është përfshirë në aplikacionin e KEK-ut të këtij viti. Trajtimi i atij lejimi në SHTE4 do të shqyrtohet më poshtë në këtë dokument.

ZRRE thekson se Neni 38 i Ligjit të sapo miratuar të Energjisë Elektrike Nr. 03/L-201 kërkon që një ndërmarrje e energjisë në pronësi publike, që nuk mund të jetë Operatori i Sistemit të Transmisionit, do të ketë obligimin e importit të energjisë për nevoja të konsumatorëve të pakualifikuar në ato periudha kohore kur në të kundërtën këta konsumatorë do të shkyçeshin. Kjo çështje do të trajtohet si obligim për shërbim publik, kostot e arsyeshme të së cilit do të kompensohen nga tarifat e konsumatorëve të rregulluar, në pajtim me Nenin 16.4 të Ligjit për Energjinë Nr. 03/L-184. ZRRE do të hartojë propozimet për mënyrën e trajtimit të importeve si pasojë e ligjeve të reja në një të ardhme të afërt.

### 4.3 Shpenzimet tjera operative

#### 4.3.1 Borxhet e këqija

KEK-u ka kërkuar që në të Hyrat e Lejuara t'i lejohet të mbulojë 5 milionë euro për borxhe të këqija. Në shqyrtimet e kaluara tarife, ZRRE nuk ka pranuar t'i lejojë KEK-ut që borxhet e këqija të përfshihen në të Hyrat e Lejuara. Megjithatë në dokumentin "Përgjigjet ndaj Komenteve" të SHTE4 ZRRE kishte thënë se "ZRRE-ja do të rishqyrtojë qasjen e saj ndaj borxheve të këqija në të ardhmen, në pajtueshmëri me praktikën ndërkombëtare të trajtimit të këtyre borxheve" (Pjesa 3.4).

KEK-u momentalisht i trajton borxhet e këqija si rivlerësim i llogarive të arkëtueshme në bilancin e gjendjes. Më pas, ndryshimi në vlerën e rivlerësuar përfshihet si shpenzim operativ në pasqyrën e të hyrave.

Ligji për të Tatimin në të Ardhura të Korporatave konsideron që borxhet e këqija mund të trajtohen si shpenzime atëherë kur ato përmbushin kriteret në vijim:

- 1.1. nëse shuma që i përgjigjet borxhit është përfshirë më parë në të ardhura;
- 1.2. nëse borxhet janë shlyer në librat e tatimpaguesit si të pavlefshme; dhe
- 1.3. nëse ekziston dëshmi adekuate e përpjekjeve të mëdha të pasuksesshme të bëra nga tatimpaguesi për arkëtimin e borxhit.
2. Borxhet e këqija që janë zbritur si shpenzime dhe pastaj janë arkëtuar më vonë, përfshihen si të ardhura në momentin e arkëtimit.

KEK ka deklaruar se trajtimi i KEK-ut ndaj borxheve të këqija është kompatibil me këto kërkesa si dhe me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (SNRF) që llogaritë e arkëtueshme të deklarohen në vlerën e tyre të kthyeshme (të mos përfshijnë borxhet e pakthyeshme).

KEK-u ka raportuar shpenzime të borxheve të këqija prej 31.5 milionë euro në vitin 2008 dhe 25.6 milionë euro në vitin 2009. Megjithatë, kërkesa e KEK-ut është që në të Hyrat e Lejuara për vitin 2011 t'i lejohet mbulesa e borxhit të keq në vlerë prej 5 milionë eurosh. Kjo vlerë, që paraqet përafërsisht 2.5% të të Hyrave të pritura nga shitjet e vitit 2011, është e krahasueshme me vlerat e lejuara ndërkombëtarisht dhe si e tillë është e pranueshme nga ZRRE-ja.

Duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, ZRRE ka përfshirë kërkesën e KEK për lejimin e Borxhit të Keq në të Hyrat e Lejuara të SHTE5. Megjithatë, ZRRE nuk synon të lejojë KEK-un që në të Hyrat e Rregulluara të mbulojë nivele të Borxhit të Keq që tejkalojnë nivelet që konsiderohen të arritshme nga një kompani e energjisë elektrike e cila menaxhohet në mënyrë të duhur.

#### 4.3.2 Margjina e furnizimit

Në aplikacionin tarifor, KEK-u ka kërkuar marginën të furnizimit prej 2.4 milionë eurosh, që paraqet 1.3% të kostos së përafërt të blerjes së energjisë për të mbuluar kërkesën me energji nga tarifata e

## Të Hyrat e Lejuara

rregulluara. ZRRE e ka ngritur margjinën në 3%, për të reflektuar praktikat e mëparshme të ZRRE-së për margjinën e furnizimit.

### 4.3.3 Ngarkesat e KOSTT-it

Në aplikacionin e tyre, KEK ka vlerësuar se pagesat neto ndaj KOSTT-it (pas zbritjes së pagesave për humbje<sup>4</sup>) do të jenë 12.2 milionë euro. ZRRE ka përshtatur këtë vlerë për të reflektuar qëndrimin e ZRRE-së për të Hyrat e KOSTT-it prej 10.2 milionë euro. Kjo paraqet zbritje prej 2 milionë euro.

## 4.4 Shpenzimet kapitale, Baza e Rregulluar e Aseteve, Zhvlerësimi dhe Kthimi i Lejuar

ZRRE ka pranuar të gjitha shpenzimet kapitale të parashikuara në aplikacionin e KEK-ut. ZRRE thekson se në të kaluarën KEK-u ka dështuar në mënyrë të vazhdueshme që investimet kapitale t'i realizojë në nivelin që ka parashikuar. Nëse kjo përsëritet gjatë vitit 2011, të Hyrat në vitin tjetër do të përshtaten për mbi-vlerësimin e lejimeve të zhvlerësimit dhe të kthimit të lejuar, siç është vepruar deri më tani. ZRRE është informuar nga KEK-u se fondet për shumicën e investimeve kapitale që kanë të bëjnë me minierat janë të gatshme, dhe për këtë arsye nuk pritet të ketë dështime në realizimin e këtyre investimeve.

## 4.5 Të Hyrat e parregulluara

### 4.5.1 Subvencionet për import

Në kohën e hartimit të këtij Raporti, qeveria ende nuk është formuar nga zgjedhjet e dhjetorit 2010. Si rezultat, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK) për vitin 2011 nuk është aprovuar ende.

Në llogaritjet e saja për të Hyrat e Lejuara, ZRRE ka supozuar se vlera e draft-Buxhetit për blerjen e energjisë nga importet prej 33.05 milionë eurosh do të mbetet e pandryshuar. Nëse BKK aprovohet para vendimit final të ZRRE-së, atëherë të Hyrat e Lejuara do të korrigjohen për të marrë parasysh vlerën finale të subvencionit për import. Nëse BKK nuk aprovohet para vendimit final të ZRRE-së, atëherë çdo ndryshim në mes të importeve të supozuara nga ZRRE-ja dhe atyre të dhëna nga BKK do të kompensohen në vitin vijues.

### 4.5.2 Të Hyrat e parregulluara nga shitjet të konsumatorët e kualifikuar

Momentalisht KEK është duke furnizuar Ferronikelin me kontratë komerciale dhe me tarifa të parregulluara. ZRRE zbret të Hyrat e pritura nga këto shitje të parregulluara nga të Hyrat që duhen mbuluar nga tarifat e rregulluara. Këto të Hyra llogariten me supozimin se Ferronikeli furnizohet me

---

<sup>4</sup> Një pjesë e ngarkesave që KEK-u ia paguan KOSTT-it përbëhet nga kostoja e blerjes së energjisë për të mbuluar humbjet në rrjetin e transmisionit. Për qëllime të llogaritjes së të Hyrave të Lejuara, lejimet për KOSTT-in për blerjen e humbjeve në transmision dhe të ardhurat që KEK-u pritet të mbledhë nga shitja e kësaj energjie janë të barabarta dhe, si të tilla, anulohen.

## Të Hyrat e Lejuara

të njëjtën kosto mesatare me shumicë si konsumatorët e tjerë, si dhe marrin parasysh kostot e transmisionit.

Kontrata e tanishme do të skadojë në prill të vitit 2011. Deri më tani ende nuk është e qartë nëse Ferronikeli do të vazhdojë të furnizohet nga KEK-u me tarifa të parregulluara, të furnizohet nga KEK-u me tarifa të rregulluara, apo do të furnizohet nga ndonjë i licencuar tjetër me tarifa të parregulluara. Kjo që po theksohet nuk duhet të konsiderohet si vendim i ZRRE-së nëse duhet apo jo që Ferronikeli të furnizohet me tarifa të rregulluara në të ardhmen. Kjo do të varet nga vendimi i Ferronikelit për të kërkuar që të furnizohet me tarifa të rregulluara, dhe nga vendimi i ZRRE-së nëse ekziston apo jo konkurrencë e mirëfilltë në furnizimin me energji (shih diskutimin e mëposhtëm).

Në vartësi nga fakti nëse Ferronikeli do të marrë apo jo tarifat e rregulluara para vendimit final të ZRRE-së për tarifat e vitit 2011, atëherë tarifat do të përshtaten sipas situatës.

### 4.6 Përshtatjet

#### 4.6.1 Përshtatjet për shpenzimet kapitale

Si në vitet e kaluara, ashtu edhe në këtë vit, ZRRE ka përshtatur të Hyrat e Lejuara për të zbritur mbi kompensimin nga lejjimet për investimet kapitale të cilat KEK-u në fakt nuk i ka realizuar. Këto lejjime përfshijnë diferencën në mes të zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar për investimet e lejuara dhe ato të realizuara. Ky ndryshim kthehet me normë interesi prej 8.15%, që paraqet normën komerciale për huat afat-shkurtra dhe që paraqet të Hyrat me interes apo pagesat që asociohen (shtohen-shoqërohen) me këto mbi kompensime.

Në të Hyrat e Lejuara të SHTE4, ZRRE kishte lejuar KEK-un të mbulojë kostot e zhvlerësimit dhe të kthimit të lejuar për shpenzimet kapitale që ishin paraparë të investohen gjatë SHTE4. Në këtë drejtim, ZRRE kishte lejuar që KEK të mbulojë 3.4 milionë euro si kosto të zhvlerësimit dhe 8.9 milionë euro si kosto të kthimit të lejuar për shumën e investuar prej 135.8 milionë euro.

Në aplikacionin tarifor të SHTE5, KEK-u ka raportuar të ketë investuar vetëm 85.5 milionë euro. Për këtë arsye, ZRRE ka përshtatur kostot e zhvlerësimit dhe të kthimit të lejuar, për të reflektuar ndryshimin në mes të vlerës së lejuar të investimeve kapitale dhe asaj të realizuar. Si rezultat, ZRRE do të zbrisë shumën totale prej 4.8 milionë eurosh. Përshtatjet e ZRRE-së janë përshkruar në tabelën në vijim:

**Tabela 2: Përshtatjet për mos-realizimin e shpenzimeve kapitale**

|                                 |             | Minierat      | Gjenerimi     | Distribucioni | Furnizimi | AQ          | Gjithsej KEK  |
|---------------------------------|-------------|---------------|---------------|---------------|-----------|-------------|---------------|
| <b>Shpenzimet Kapitale</b>      |             |               |               |               |           |             |               |
| Të lejuara (nga donatorët)      | €000        | 0             | 0             | 0             | 0         | 0           | 0             |
| Të realizuara (nga donatorët)   | €000        | 0             | 0             | 0             | 0         | 0           | 0             |
| Të lejuara (financim tjetër)    | €000        | 73,500        | 30,000        | 26,400        | 465       | 5,400       | 135,765       |
| Të realizuara (financim tjetër) |             | 56,000        | 18,600        | 6,515         | 446       | 3,951       | 85,512        |
| <b>Zhvlërësimi</b>              |             |               |               |               |           |             |               |
| Jetëgjatësia                    | Vite        | 25            | 16            | 30            | 5         | 5           | n/a           |
| Të lejuara                      | €000        | 1,470         | 938           | 440           | 47        | 540         | 3,434         |
| Të realizuara                   | €000        | 1,120         | 581           | 109           | 45        | 395         | 2,250         |
| Azhustimi                       | €000        | -350          | -356          | -331          | -2        | -145        | -1,184        |
| <b>Return</b>                   |             |               |               |               |           |             |               |
| WACC                            |             | 13.10%        | 13.10%        | 13.10%        | 13.10%    | 13.10%      | J/a           |
| Të lejuara                      | €000        | 4,814         | 1,965         | 1,729         | 30        | 354         | 8,893         |
| Të realizuara                   | €000        | 3,668         | 1,218         | 427           | 29        | 259         | 5,601         |
| Azhustimi                       | €000        | -1,146        | -747          | -1,302        | -1        | -95         | -3,292        |
| <b>Gjithsej Azhustimi</b>       |             |               |               |               |           |             |               |
| Gjithsej para interesit         | €000        | -1,496        | -1,103        | -1,634        | -3        | -240        | -4,476        |
| Norma afat-shkurtër e interesit |             | 8.15%         | 8.15%         | 8.15%         | 8.15%     | 8.15%       | J/a           |
| <b>Gjithsej pas interesit</b>   | <b>€000</b> | <b>-1,618</b> | <b>-1,193</b> | <b>-1,767</b> | <b>-3</b> | <b>-259</b> | <b>-4,841</b> |

#### 4.6.2 Lejimet për import emergjent

ZRRE ka lejuar që në të Hyrat e KEK-ut në kuadër të SHTE4 të përfshihet edhe lejimi prej 10.2 milionë euro për blerjen e energjisë nga importi. Ky lejim ishte dhënë me kushtin që KEK-u të furnizojë 24:0 të gjitha kategoritë e konsumatorëve<sup>5</sup>.

Në fakt KEK-u ka dorëzuar evidencë që dëshmon se nuk ka mundur të plotësojë kushtin për furnizim 24:0 ndaj të gjitha kategorive. Shkyçjet mesatare ditore kanë qenë 11 minuta për kategorinë A, 59 minuta për kategorinë B dhe 2 orë e 40 minuta për kategorinë C.

Duke pasur parasysh faktin se KEK-u ka dështuar të përmbushë kushtin e deklaruar për furnizim, ZRRE do të zbrisë 10.2 milionë euro nga të Hyrat e KEK-ut në SHTE5, me normën e interesit të aplikuar për përshtatjet e tjera.

#### 4.6.3 Përshtatja e Subvencioneve

Gjatë SHTE4, ZRRE kishte supozuar se niveli i subvencioneve të dhëna KEK-ut nga BKK i vitit 2010 do të ishte 40 milionë euro<sup>6</sup>. Të dhënat e dorëzuara nga KEK-u dhe të dhënat e Ministrisë së Ekonomisë

<sup>5</sup> KEK kishte deklaruar në aplikacionin e SHTE4 se përfshirja e këtij lejimi do t'i mundësonte të furnizojë 24:0 konsumatorët e kategorive A dhe B. Megjithatë ZRRE kishte deklaruar se kërkesa e e tillë mund ta detyrojë KEK-un të reduktojë në mënyrë ekscesive kategorinë C, vetëm për të përmbushur kushtin e furnizimit 24:0 për kategorinë A dhe B. Prandaj në dokumentin "Përgjigjet ndaj Komenteve" në kuadër të SHTE4 ZRRE kishte deklaruar se "do të lejojë vlerën e kërkuar për blerjen e energjisë nga importi vetën nëse të gjitha kategoritë furnizohen në mënyrë të njëjtë pa diskriminim"

## Të Hyrat e Lejuara

dhe të Financave dëshmojnë se në fakt KEK-u ka marrë €29.02 milionë. Për këtë arsye, ZRRE ka përfshirë në propozimin e saj kompensimin për KEK-un për diferencën prej 10.9 milionë eurosh si për dhe koston e interesit që shoqërohet me to.

### 4.6.4 Rregullimi i furnizimit në veri të lumit Ibër

Në SHTE4 ZRRE kishte lejuar që KEK-ut t'i lejohen 3 milionë euro për të mbuluar koston e rregullimit të furnizimit në veri të lumit Ibër (për blerjen e njehsorëve të rinj). Meqenëse KEK-u nuk ka qenë i suksesshëm në rregullimin e furnizimit në veri, ZRRE do të zbresë këto mjete të pashfrytëzuara prej 3 milionë euro me normën e aplikueshme të interesit.

## 4.7 Përmbledhje e të Hyrave të Lejuara

Sipas llogaritjeve të ZRRE-së, të Hyrat e kërkuara nga KEK-u për vitin 2011 në bazë të Modelit Tarifor të përdorur nga ZRRE-ja që i është dërguar KEK-ut, arrijnë vlerën €201.3 milionë euro. Kjo do të paraqiste rritje të të Hyrave të Lejuara prej 28.7%, krahasuar me vlerën e caktuar nga ZRRE prej 156.5 milionë euro në vitin 2010. KEK-u po ashtu parasheh rritje të shitjeve të energjisë elektrike prej 24.3%, nga 2,800 GWh në 3,481 GWh. Rritja e shitjes vjen si rezultat i parashikimeve që Ferronikeli do të shndërrohet në konsumator që furnizohet nga tarifat e rregulluara. Shitjet vjetore për Ferronikelin janë parashikuar të jenë 678 GWh.

Për këtë arsye, sipas aplikacionit të KEK-ut do të rezultonte një rritje e tarifës mesatare prej 3.5%, nga 5.59 €/kWh në 5.78 €/kWh.

Më poshtë jepet struktura e të Hyrave sipas aplikacionit të KEK-ut

**Tabela 3: Të Hyrat e Lejuara – aplikacioni i KEK-ut**

|   | €000        | Minierat      |               | KEK           |               |                | KOSTT         | GJITHSEJ       |
|---|-------------|---------------|---------------|---------------|---------------|----------------|---------------|----------------|
|   |             | Gjenerimi     | Distribucioni | Furnizimi     | Gjithsej KEK  |                |               |                |
| Shpenzimet Operative                      | €000        | 42,244        | 30,802        | 16,714        | 15,734        | 105,494        | 9,009         | 114,503        |
| Zhvlerësimi                               | €000        | 8,899         | 4,912         | 1,143         | 439           | 15,392         | 439           | 15,831         |
| Kthimi i lejuar                           | €000        | 22,152        | 6,663         | 3,308         | 1,421         | 33,544         | 1,209         | 34,754         |
| Importi                                   | €000        |               |               |               | 53,166        | 53,166         |               | 53,166         |
| Blerjet e energjisë jashtë KEK-ut         | €000        |               |               |               | 3,971         | 3,971          |               | 3,971          |
| Shërbimet Ndhimëse                        | €000        |               |               |               |               | 0              | 1,600         | 1,600          |
| Kostot e alokuara të AQ                   | €000        | 5,470         | 2,708         | 1,827         | 2,055         | 12,061         |               | 12,061         |
| <b>Gjithsej Kostot e Lejuara</b>          | <b>€000</b> | <b>78,765</b> | <b>45,085</b> | <b>22,992</b> | <b>76,786</b> | <b>223,628</b> | <b>12,257</b> | <b>235,886</b> |
| Shitjet ndaj konsumatorëve të kualifikuar | €000        |               |               |               | 0             | 0              |               | 0              |
| Eksporti                                  | €000        |               |               |               | -4,467        | -4,467         |               | -4,467         |
| Të hyrat tjera operative                  | €000        | -1,500        | -1,600        |               |               | -3,100         |               | -3,100         |
| Subvencionet                              | €000        |               |               |               | -33,050       | -33,050        |               | -33,050        |
| Azhustimet                                | €000        | -1,859        | -2,075        | -1,806        | 11,826        | 6,085          | -25           | 6,061          |
| <b>Gjithsej të Hyrat e Lejuara</b>        | <b>€000</b> | <b>75,406</b> | <b>41,410</b> | <b>21,185</b> | <b>51,096</b> | <b>189,097</b> | <b>12,232</b> | <b>201,330</b> |
| Gjithsej shitjet e Furnizuesit Publik     |             |               |               |               |               |                | GWh           | 3,481          |
| <b>TARIFA MESATARE E NEVOJSHME</b>        |             |               |               |               |               |                | €/kWh         | <b>5.78</b>    |

<sup>6</sup> 10 milion euro janë bartur nga niveli i subvencioneve të vitit 2009

## Të Hyrat e Lejuara

Pas përshtatjeve të bilancit energjetik dhe të të Hyrave të Lejuara, të përshkruara më lart, ZRRE vlerëson se të Hyrat e nevojshme për KEK-un për vitin 2011 janë 184.6 milionë euro, që paraqet një rritje prej 18 % nga të Hyrat e Lejuara në kuadër të SHTE4. Shitjet nga tarifat e rregulluara janë vlerësuar të jenë 3,600 GWh, që paraqet rritje prej 28.6% krahasuar me SHTE4. Për këtë arsye, vlerësimet e përgjithshme të ZRRE-së rezultojnë me një ulje prej 8.2% të tarifës së tanishme mesatare me pakicë respektivisht në 5.13 €/kWh.

Vlerësimet e ZRRE-së janë paraqitur në Tabelën 4.

**Tabela 4: Të Hyrat e Lejuara – Vlerësimet e ZRRE-së**

|   | €000        | -----         |               | KEK           |               | -----                              |                                  | KOSTT-i        | GJITHSEJ |
|---|-------------|---------------|---------------|---------------|---------------|------------------------------------|----------------------------------|----------------|----------|
|   |             | Minierat      | Gjenerimi     | Distribucioni | Furnizimi     | KEK-u                              |                                  |                |          |
| Shpenzimet Operative                      | €000        | 42,244        | 30,802        | 16,714        | 18,435        | <b>108,194</b>                     | 6,866                            | <b>115,060</b> |          |
| Zhvlerësimi                               | €000        | 8,899         | 4,912         | 1,143         | 439           | <b>15,392</b>                      | 456                              | <b>15,849</b>  |          |
| Kthimi I Lejuar                           | €000        | 22,152        | 6,663         | 3,308         | 1,421         | <b>33,544</b>                      | 1,290                            | <b>34,834</b>  |          |
| Importi                                   | €000        |               |               |               | 50,114        | <b>50,114</b>                      |                                  | <b>50,114</b>  |          |
| Blerjet jashtë KEK-ut                     | €000        |               |               |               | 3,971         | <b>3,971</b>                       |                                  | <b>3,971</b>   |          |
| Shërbimet Ndihmëse                        | €000        |               |               |               |               | <b>0</b>                           | 1,600                            | <b>1,600</b>   |          |
| Kostot e AQ                               | €000        | 5,470         | 2,708         | 1,827         | 2,055         | <b>12,061</b>                      |                                  | <b>12,061</b>  |          |
| <b>GJITHSEJ KOSTOT E LEJUARA</b>          | <b>€000</b> | <b>78,765</b> | <b>45,085</b> | <b>22,992</b> | <b>76,434</b> | <b>223,276</b>                     | <b>10,212</b>                    | <b>233,489</b> |          |
| Shitjet ndaj konsumatorëve të kualifikuar | €000        |               |               |               | 0             | <b>0</b>                           |                                  | <b>0</b>       |          |
| Eksporti                                  | €000        |               |               |               | -4,467        | <b>-4,467</b>                      |                                  | <b>-4,467</b>  |          |
| Te hyrat tjera operative                  | €000        | -1,500        | -1,600        |               |               | <b>-3,100</b>                      |                                  | <b>-3,100</b>  |          |
| Subvencionet                              | €000        |               |               |               | -33,050       | <b>-33,050</b>                     |                                  | <b>-33,050</b> |          |
| Pershtatjet                               | €000        | -1,859        | -2,075        | -1,806        | -2,479        | <b>-8,220</b>                      | -25                              | <b>-8,245</b>  |          |
| <b>GJITHSEJ TE HYRAT E LEJUARA</b>        | <b>€000</b> | <b>75,406</b> | <b>41,410</b> | <b>21,185</b> | <b>36,438</b> | <b>174,440</b>                     | <b>10,187</b>                    | <b>184,627</b> |          |
|   |             |               |               |               |               |                                    | Shitjet e furnizuesit publik GWh | 3,600          |          |
|   |             |               |               |               |               | <b>TARIFA E NEVOJSHME MESATARE</b> | €/kWh                            | <b>5.13</b>    |          |

Tarifat e nevojshme mesatare me pakicë të kërkuara nga KEK-u dhe të vlerësuara nga ZRRE-ja janë dhënë në Tabelën 5.

**Tabela 5: Tarifat mesatare me pakicë**

| <b>TARIFA MESATARE ME PAKICË</b> |              |             |             |             |             |              |
|----------------------------------|--------------|-------------|-------------|-------------|-------------|--------------|
|                                  |              | E aprovuar  | Aplikacioni | Ndryshimi   | ZRRE        | Ndryshimi    |
| Vëllimi I shitjeve               | GWh          | 2,800       | 3,481       | 24.3%       | 3,600       | 28.6%        |
| Të hyrat e lejuara               | €000s        | 156,465     | 201,330     | 28.7%       | 184,627     | 18.0%        |
| <b>Tarifa mesatare me pakicë</b> | <b>€/kWh</b> | <b>5.59</b> | <b>5.78</b> | <b>3.5%</b> | <b>5.13</b> | <b>-8.2%</b> |

Ndryshimi në mes të të Hyrave të kërkuara nga KEK dhe të Hyrave të vlerësuara nga ZRRE është 16.7 milionë euro. Pjesa më e madhe e këtij ndryshimi është zbritja e lejimit për importe emergjente si rezultat i dështimit të KEK-ut për të përmbushur cakun e kërkuar të furnizimit, zbritja e lejimit për rregullimin e furnizimit në veri të lumit Ibër, si dhe zbritja në humbjet e lejuara. Bashkërenditja e aplikacionit të KEK-ut dhe vlerësimeve të ZRRE-së është dhënë në Tabelën 6.

**Tabela 6: Bashkërenditja e aplikacionit të KEK-ut dhe lejimeve të ZRRE-së.**

| BASHKËRENDITJA E TË HYRAVE TË LEJUARA              |                |
|--|----------------|
|  | €000           |
| <b>Aplikacioni I KEK-ut</b>                        | <b>201,330</b> |
| Zbritja e humbjeve/importit                        | -3,052         |
| Rritja e margjinës së furnizimit                   | 2,700          |
| Zbritja e lejesave për import                      | -11,061        |
| Zbritja e provizionit për rregullimin e furnizimit | -3,245         |
| Ndryshimi në të Hyrat e KOSTT-it                   | -2,045         |
| <b>Propozimi I ZRRE-së</b>                         | <b>184,627</b> |

## 5 Ngarkesat e propozuara të SHSD

Në aplikacionin e tyre KEK ka propozuar një metodologji për përcaktimin e tarifave për SHSD, pasi të jenë vlerësuar të Hyrat e Lejuara të Operatorit të Sistemit të Distribucionit. Kjo metodologji alokon koston e distribucionit si dhe koston e humbjeve në mes të niveleve të ndryshme të tensionit, bazuar në pjesëmarrjen e tyre në ngarkesën e pikut, apo në rrjedhat e energjisë, apo në shitjet, varësisht se cila kosto alokohet. Ngarkesat rezultuese të SHSD përcaktohen duke mbledhur këta komponentë kostosh dhe shprehen si tarifa të energjisë (në €/kWh).

Metodologjia e KEK-ut për vlerësimin e ngarkesave të SHSD nuk është kompatible me metodologjinë e ZRRE-së e cila kërkon që kostot e ngarkesës dhe ato të energjisë të jenë të ndara, si dhe alokimi i kostove të bëhet në bazë të kostos margjinale afat-gjatë (KMAG) për secilin nivel tensioni. Megjithatë, ligji i ri për Rregullatorin e Energjisë ua mandaton të licencuarve përgjegjësinë për propozimin e strukturave të ngarkesave të distribucionit (pas aprovimit të ZRRE-së). Duke pasur parasysh këtë, dhe faktin se gjasat për zhvillimin e konkurrencës me pakicë tek konsumatorët e kyçur në nivel distribicioni janë të vogla, ZRRE konsideron se do të ishte e tepërt që të kërkohej aplikimi i metodologjisë së propozuar për këtë shqyrtim tarifor. Kjo nuk do të thotë se ZRRE e pranon metodologjinë e propozuar tarifore. Qëndrimi i ZRRE-së mbi propozimin e KEK-ut do të varet nga shqyrtimi i ZRRE-së mbi metodologjinë tarifore kur KEK-u ta dorëzojë atë në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

## 6 Çështjet e tjera

### 6.1 Tarifa e nivelit 220 kV

Në aplikacionin e KEK-ut thuhet se KEK-u do të refuzojë të furnizojë me kontratë të parregulluar Ferronikelin pasi që të skadojë kontrata e tanishme dhe për këtë arsye, në aplikacionin tarifor, kërkon që Ferronikeli të trajtohet si konsumator që do të faturohet me tarifa të rregulluara. ZRRE vlerëson se KEK-u mund të ketë keqkuptuar kërkesat ligjore në këtë drejtim. Neni 18.6.2 i Ligjit për Energjinë Elektrike thotë se:

18.6 Furnizuesi publik do të:

6.1 furnizojë energji elektrike për të gjithë konsumatorët e pa kualifikuar që kërkojnë një gjë të tillë;

6.2 furnizojë energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar nëse kërkohen për të bërë një gjë të tillë, me kusht që ky furnizim bëhet vetëm në tarifa të rregulluara të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë për konsumatorë të tillë të kualifikuar, si dhe sipas kushteve që mund t'i përcaktojë Zyra e Rregullatorit për Energji;

Për këtë arsye KEK-u, si Furnizues Publik, nuk mund të refuzojë kërkesën e Ferronikelit për t'u furnizuar. Megjithatë, KEK-u mund t'i vendosë tarifën dhe ngarkesat që aplikohen, përveç nëse ZRRE vendos se duhet të aplikohet tarifë e rregulluar. Neni 41.1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë thekson se tarifa e rregulluar aplikohet për konsumatorët e kualifikuar vetëm atëherë kur ZRRE vlerëson se nuk ka konkurrencë efektive në furnizim me energji elektrike. ZRRE është në procesin e hartimit të kriterëve për vlerësimin e ekzistimit të konkurrencës efektive në treg. Këto kritere do të publikohen për konsultim me publikun.

Pa paragjykuar konkluzionet e ZRRE-së pas shqyrtimeve për efektivitetin e konkurrencës në furnizim dhe pa paragjykuar nëse Ferronikeli do të jetë konsumator i furnizuar me tarifë të rregulluar, për qëllim të këtij shqyrtimi tarifor, ZRRE ka ndjekur qasjen e KEK-ut duke supozuar se Ferronikeli do të jetë konsumator i rregulluar.

### **6.2 Vlerësimi i asetëve para vitit 2006**

Në aplikacionin e tyre KEK-u ka përfshirë edhe një vlerësim të ndikimit të përfshirjes së asetëve të para 2006 në RAB me vlerën historike të zhvlerësimit të tyre (vlerën që figuron në pasqyrat financiare të audituara të KEK-ut). KEK-u thekson se Neni 43 i ligjit të ri për Rregullatorin e Energjisë thotë se:

3. Gjatë miratimit apo caktimit të tarifave, Zyra e Rregullatorit për Energji do të sigurojë që të licencuarve t'u mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme, përfshirë:

.....

3.6. koston normale të zhvleftësimit mbi të gjitha asetet e përfshira në Bazën e Asetëve të Rregulluara, dhe "Baza e Asetëve të Rregulluara" nënkupton të gjitha asetet e përdorura dhe të dobishme në ofrimin e shërbimeve nga subjekti i rregulluar, përveç asetëve plotësisht të zhvleftësuar;

ZRRE ka theksuar në letrën e Parimeve dhe të Orarit të dërguar më 30 dhjetor 2010 se ky shqyrtim tarifor do të realizohet nën metodologjinë ekzistuese, sipas të cilës asetet e viteve para vitit 2006 kanë vlerë zero. KEK-u në aplikacionin e tyre po ashtu thekson se:

KEK-u kupton se legjislacioni sekondar, si Metodologjia Tarifore, do të rishqyrtohet gjatë vitit 2011 për të eliminuar konfliktet eventuale me legjislacionin e ri primar. Për këtë arsye, KEK-u ka vendosur që t'i ofrojë informatat për të Hyrat e Lejuara për vitin 2011 sikur në to të përfshiheshin zhvlerësimi dhe kthimi i lejuar për asetet e viteve para 2006.

## Propozimet e ZRRE-së për tarifat e rregulluara

ZRRE konfirmon se në propozimet e saja të dhëna në këtë dokument ka vlerësuar në zero asetet para vitit 2006. ZRRE do të konsultohet në lidhje me amandamentimet e Metodologjisë Tarifore si pasojë e kërkesave të ligjit të ri për Rregulatorin e Energjisë në një të ardhme të afërt.

### 6.3 Tantiema për linjit

Aplikacioni tarifor i KEK-ut po ashtu përfshin një vlerësim të tarifave të nevojshme për mbulimin e kostos së rritjes së tantiemës, të vlerësuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) në takimin e 27 gushtit të vitit 2010, që i është komunikuar KEK-ut më 23 shtator të vitit 2010.

Pas dorëzimit të aplikacionit të KEK-ut, KPM e ka pezulluar vendimin e tij dhe për këtë arsye në propozimin e ZRRE-së konstatohet se tantiema për energji mbetet e pandryshuar.

## 7 Propozimet e ZRRE-së për tarifat e rregulluara

### 7.1.1 Të Hyrat e Lejuara

ZRRE vlerëson se niveli i duhur i të Hyrave të Lejuara që Furnizuesi Publik i KEK-ut duhet të mbledhë nga tarifat e rregulluara pas 1 prillit 2011 është 184.6 milionë euro. Kjo vlerë paraqet rritje prej 18.0% nga të Hyrat e Lejuara në kuadër të SHTE4. ZRRE parasheh që shitjet nga tarifat e rregulluara të arrijnë nivelin 3,600 GWh, që paraqet rritje prej 28.6% nga shitjet e SHTE4. Kjo implikon një ulje prej 8.2% të tarifës së tanishme mesatare të rregulluar me pakicë, respektivisht nga 5.59 €/kWh në 5.13 €/kWh.

Përveç ndryshimeve eventuale që mund të vijnë nga komentet e palëve të interesit, ZRRE dëshiron të theksojë se vlerësimet e saja bazohen në dy supozime shumë të rëndësishme:

- Vlerësimet e ZRRE-së supozojnë se Ferronikeli do të furnizohet me tarifë të rregulluar që reflekton koston e shërbimit, pas skadimit të kontratës së saj të parregulluar në prill 2011. Është e mundur që Ferronikeli të mos furnizohet nga KEK-u në të ardhmen, ose mund të ndodhë që të furnizohet me tarifë të parregulluar, nëse ZRRE vlerëson se konkurrenca në furnizim është efektive.
- Subvencioni i lejuar për blerjen e energjisë nga importi në BKK-në e vitit 2011 do të mbetet e njëjtë me atë të Draft Buxhetit të Tetorit 2010, në vlerë prej 33.05 milionë eurosh.

Çdo ndryshim në këto supozime do të lindë nevojën për ndryshime të vlerësimit të të Hyrave të Lejuara dhe, si rezultat, të tarifave të rregulluara nga ana e ZRRE-së.

### 7.1.2 Përshtatja e propozuar e tarifave

Megjithëse vlerësimet e ZRRE-së implikojnë se ekziston mundësia e uljes së tarifave të energjisë elektrike në këtë vit, ZRRE vlerëson se kjo nuk duhet të ndodhë. ZRRE vlerëson se tarifat e rregulluara mund të rriten në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2011 si pasojë e:

## Propozimet e ZRRE-së për tarifat e rregulluara

- Rritjes së përbërjes së kostos së importit në koston totale të blerjes së energjisë, deri sa të ndërtohen kapacitetet e reja gjeneruese.
- Rishqyrtimit të Metodologjisë Tarifore si pasojë e Ligjit të ri për Rregullatorin e Energjisë, në veçanti nevojën për përfshirjen e kostove të zhvlerësimit për asetet e viteve para 2006.
- Zvogëlimeve të vazhdueshme të subvencioneve të importit nga BKK, të cilat parashihen të zvogëlohen për çdo vit, për të arritur kështu vlerën 0€ në vitin 2014.

Duke pasur parasysh faktin se këta faktorë mund të ndikojnë në rritje të konsiderueshme të tarifave në të ardhmen, **ZRRE propozon të mos ndryshojë tarifat e rregulluara me pakicë për vitin 2011.**

### 7.1.3 Llogaria Balancuese e Tarifave (LBT)

ZRRE do ta trajtojë ndryshimin në mes të vlerësimit të saj për të Hyrat e Lejuara të nevojshme për KEK-un dhe të Hyrave që KEK pritet t'i mbledhë nga tarifat e tanishme si masë balancuese, që mund të përdoret për të zbutur rritjet e pritshme të tarifave të energjisë elektrike në të ardhmen.

Ky ndryshim do të alokohet në Llogarinë Balancuese të Tarifave (LBT). Bilanci i kësaj llogarie do të përshtatet për të marrë parasysh interesin, në të njëjtën mënyrë si përshtatjet e tjera të deritanishme. Në vitin vijues tarifor, LBT-ja do të jetë në dispozicion dhe, sipas vlerësimit të ZRRE-së, do të përdoret për të zbutur ose eliminuar rritjet e tarifave. Çdo pjesë e papërdorur e LBT-së apo çdo shtesë e LBT-së, si pasojë e vendimeve të ZRRE-së, do të bartet në vitet e ardhshme tarifore.

ZRRE vlerëson se ndryshimi në mes të të Hyrave të Lejuara të vlerësuar nga ZRRE-ja dhe të Hyrave që pritet të mbulohen nga tarifat e rregulluara në fuqi është 16.5 milionë euro. Kjo është vlera që do t'i kreditohej LBT-së. Nëse në vitin që vjen, të Hyrat e Lejuara rriten nga rrethanat e përshkruara në Pikën 7.1.2, atëherë ZRRE-ja do të zbrisë LBT-në nga ajo vlerë e të Hyrave të Lejuara, që do të ndikonte në zbutjen e rritjes ekscesive të tarifave në të ardhmen.

**Tabela 7: Llogaritja e bilancit të LBT-së**

|  | Tarifa Mesatare Shitjet e pritura |         | Të Hyrat      |
|--|-----------------------------------|---------|---------------|
|  | €/kWh                             | GWh     | €000s         |
| Të hyrat e mbledhura nga tarifat në fuqi       | 5.59                              | 3,600.3 | 201,163.7     |
| Të hyrat e mbledhura nga tarifat e llogaritura | 5.13                              | 3,600.3 | 184,627.0     |
| <b>Ndryshimi</b>                               | <b>€000</b>                       |         | <b>16,537</b> |

ZRRE do të japë sqarime të mëtutjeshme për propozimin e saj për përcaktimin e vlerës së LBT-së si dhe zbatimin e saj, para vendimit të saj për tarifat e vitit që vjen.

## Propozimet e ZRRE-së për tarifat e rregulluara

### **7.1.4**    *Struktura tarifore*

Pas shqyrtimit të hollësishëm të Aplikacioneve ZRRE propozon që të mos bëhen ndryshime të tarifave me pakicë, andaj struktura ekzistuese tarifore do të mbetet e pandryshuar dhe do të vlejë deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifar.